



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12, 14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 të datës 04 qershor 2008, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe nenit 14 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 datë 3 Prill 2019, nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës të datës 13.08.2020 dhe nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 datë 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 29.03.2024, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

## V E N D I M

### PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ZK-LIPJAN

#### Neni 1

Me këtë Vendim i'u jepen në shfrytëzim afatgjatë personave fizik dhe juridik paluajtshmerit- pronat komunale që gjenden në Zonën Kadastrale në Lipjan të përshkruara si në vijim:

Njësia Kadastrale P-71409044-01736 -2, në sipërfaqe prej 1457m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale në Lipjan;

4, në sipërfaqe prej 624m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale në Lipjan;

Njësia Kadastrale P-71409044-01743-5, në sipërfaqe prej 803m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale në Lipjan; dhe Njësia Kadastrale P-71409044-01748-2, në sipërfaqe prej 765m<sup>2</sup>, Zona

Kadastrale në Lipjan

Sipërfaqja e përgjithshme e pronave 3649m<sup>2</sup>.

## Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave është ndërtimi i ndërtesave për banim të përballushëm. Me ndërtimin e ndërtesave në këto parcela, do të bëhet rrënimi i dy objekteve të vjetra banesore të cilat nuk i plotësojnë kushtet e banimit, po ashtu në të njëjtin proces mundësohet edhe zhvillimi i pronave private në sipërfaqe të përgjithshme prej 1156.07m<sup>2</sup>, si dhe do të bëhet rregullimi i qendrës së qytetit-Zona e parë I-rë, sipas kushteve të përcaktuara me Harten Zonale të Komunës së Lipjanit, në këto parcela është paraparë ndërtimi i lartë banesor dhe afarist me etazhitet B=P+8.

## Neni 3

Pronat e paluajtshme komunale sipas nenit 1 të këtij Vendimi jepen në shfrytëzim afatgjatë prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite nëpërmjet procedurës së Njoftimit publik nga ana e Komisionit Vlerësues sipas Vendimit të Kuvendit Komunal.

## Neni 4

Procedura e dhënies në shfrytëzim të pronave të komunës të përcaktuara në nenin 1 të këtij Vendimi bëhet përmes "Shprehjes së Interesit", duke i plotësuar edhe kriteret tjera të përcaktuara në nenin 5 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

## Neni 5

Zgjedhja e ofertës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, bazohet në kriteret e përcaktuara në nenin 20 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës përmes "Shprehjes së Interesit".

## Neni 6

Obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që pas përfundimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës sipas nenit 1 të këtij Vendimi t'i regjistroj në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim në afat prej 99 vitesh sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

## Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektorit Pronëso- Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15 Nr. 463/02-17208

Lipjan, më 29.03.2024

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

